

**Dr. Sc. Mark Palnikaj**  
**Universiteti Politeknik i Tiranës**

**SHPËRNGULJA E POPULLSISË SË RUGOVËS MË 1919  
NGA DHUNA DHE GENOCIDI I MALIT TË ZI DHE SERBISË  
SIPAS DOKUMENTEVE ARKIVORE TË ARKIVIT QENDROR  
TË SHTETIT NË TIRANË**

**Shkurtore**

*Pjesëmarrjen në këtë tubim me një kumtesë modeste e konsideroj një kujtesë dhe nderim për vuajtjet dhe fatkeqësitë njerëzore të shkaktuara nga një popullsi kufitare me shqiptarët, por me orientim barbar dhe shovinist, e cila gjatë disa shekujve nuk ka lënë krim as barbarizëm pa përdorur për shfarosjen me metoda barbare të popullsisë shqiptare në trojet e veta. Dëshmitë dhe faktet e këtyre barbarizmave i njeh sot gjithë bota falë mjeteve të informacionit dhe falë disa organizmave humane perëndimore që iu gjendën pranë popullit shqiptar në këto fatkeqësi, por edhe kujtesës dhe varreve të ruajtura nga gjyshërit tanë në këto troje. Unë jam me origjinë nga Malësia e Gjakovës e cila iu bë krah popullsisë së Rugovës në momentet më të vështira të terrorit serb dhe kam të fiksuar në kujtesën time familjare të ngulitur qysh në moshën e fëmijërisë nga familjarët e mi kujtimin e hidhur për këto masakra. Këto masakra popullsia e Gashit, Krasniqes, Nikajt, Mërturit, Shalës dhe Shoshit i ka të skalitura mrekullisht në këngët folklorike me një realizëm rrëqethës të ngjarjeve të ndodhura në vitin 1919, por edhe në vitet 1912 deri në vitin 1916 në trevat e Pejës dhe të Rugovës.*

*Tema ime modeste është e ndërtuar jo mbi bazën e kujtimeve, por bazuar mbi dokumentet arkivore që ruhen në Arkivin Qëndror të Shtetit Shqiptar për ngjarjet rrëqethëse të vitit 1919 në rrethinat e Pejës dhe posaçërisht në Rugovë. Kujtimet familjare dhe të dhënat gojore vetëm më kanë nxitur që të hulumtoj dhe të sjell në vëmendjen e brezit të ri ato ngjarje dhe fakte për ndodhitë tronditëse të asaj epoke që uroj që kurrë të*

*mos përsëritet në asnjë vend as të Shqipërisë por as të ndonjë populli tjetër kudo në botë.*

**Fjalë çelësa:** Liri, masakra, kujtesë, atdhe, krime, barbarizma.

### **Masakra e Shtupeqit në Rugovë në vitin 1919, rrethanat historike**

Për të kuptuar shkaqet e kësaj masakre është e nevojshme të paraqiten ndryshimet politike dhe historike në njëzet vjetët e parë të shekullit XX. Në këtë periudhë, nga viti 1900 deri në vitin 1919, në Perandorinë Osmane kanë ndodhur ndryshime të mëdha të cilat patën ndikim shumë të madh në rrjedhën e fateve të popullsisë shqiptare në zonat e pushtimit turk, posaçërisht popullsisë së Kosovës dhe asaj në Maqedoni. Rrjedhime negative të këtyre ndryshimeve u ndien në krejt popullsinë shqiptare në Gadishullin Ballkanik.

Revolucioni i turqve të rinj në vitin 1908 i quajtur ndryshe edhe revolucioni xhonturk krijoi paqëndrueshmëri politike në krejt hapësirat e Perandorisë Osmane. Shtetet kufitare me këtë perandori i shtuan orekset e tyre për të fituar sa më shumë terriore nga kjo perandori në dëm të popullsisë kufitare të tyre. Posaçërisht shteteve, si Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë iu shtuan orekset për të marrë sa më shumë nga tokat shiptare nën zotërimin e Turqisë.

Më 28 nëntor 1912, në qytetin e Vlorës, Shqipëria shpalli pavarësinë nga Turqia dhe krijoi mbas 500 vjetësh shtetin e saj. Menjëherë mbas këtij veprimi, Greqia vrapoi të pushtonte zonat me popullsi shqiptare në jug të Shqipërisë duke i quajtur Vorioepir, Serbia vrapoi të pushtonte Kosovën duke e quajtur Djepi i Serbisë, Mali i Zi pushtoi Shkodrën, Plavën, Gucinë, Pejën me rrethina, Gjakovën deri afër Prizrenit. Edhe Bullgarët ndërhyjnë për të pushtuar pjesë të territorit të Maqedonisë. Ky pushtim, u pasue nga masakra të përgjakshme mbi popullsinë civile të pambrojtur në rrethinat e Gjirokastrës, në Shkodër, në Shkupin me rrethinë dhe në tërë popullsinë e Kosovës.

Me ndërhyrjen e Perandorisë së Austrohungarisë në tokat shqiptare më 16 janar 1916, këto masakra u zbutën ndjeshëm dhe autoritete austrohungareze i dolën në mbrojtje popullsisë shqiptare në

zonën e tyre të okupimit. Ata bënë publike për opinionin ndërkombëtar padrejtësitë dhe masakrat e shteteve të Serbisë dhe të Malit të Zi kundra shqiptarëve dhe për rreth tre vjet masakrat u zvogëluan shumë.

Mbas përfundimit të Luftës së Parë Botërore me 11 nëntor 1918, Austrohungaria ishte me palën humbëse dhe doli shumë e dëmtuar nga kjo luftë. Por edhe popullsia shqiptare kishte humbur mbrojtësin e saj të fuqishëm. Në janar 1919 filloi Konferenca e Paqes në Paris ku u paraqitën edhe përfaqësues nga Shqipëria. Serbia dhe Mali i Zi e shfrytëzuan mungesën e shtetit të fortë në Shqipëri dhe gjendjen e turbullt ndërkombëtare dhe ndërmorën sulme kriminale ndaj popullsisë së pambrojtur të zonave të Plavës, Gucisë, Rugovës dhe disa zonave të tjera.

Serbët në muajt janar dhe shkurt ndërmorën një sulm të paprecedent ndaj popullsisë të pambrojtura në rrethinat e Pejës dhe posaçërisht në fshatrat e Rugovës ku përfshihet edhe Shtupeqi. Ata u treguan të pamëshirë duke masakruar edhe gra, fëmijë e pleq dhe duke përndjekur në drejtim të Shqipërisë ata që nuk mundën t'i vritnin. Në dokumente të kohës këto ngjarje janë të identifikuara mirë dhe për më tepër iu bënë prezente edhe shteteve evropiane në mënyrë që të merrnin masa ndaj Serbisë për të ndaluar këto masakra të papara edhe në terrorin më të zi në kohërat e mëparshme.

Fuqitë evropiane i morën disa masa të dobëta, por ndëshkimi ndaj Serbisë për këto masakra qe vetëm sa për formë, kurse ndihmat për refugjatët e larguar në mes të një dimri të egër nga trojet e tyre qenë të pamjaftueshme. Në dokumentet diplomatike të kohës këto janë plotësisht të reflektuara, por ajo që pak është e shkruar është mbështetja dhe solidariteti popullor i popullsisë tejet të varfër të Shqipërisë veriore të cilët u bënë streha e këtyre refugjatëve fatkeqë dhe ndanë me ta edhe kafshatën e fundit të bukës. Kronika të kësaj mbështetjeje janë këngët popullore dhe tregimet e pleqve të cilat për vite me radhë i kanë treguar si një realitet i trishtuar i asaj kohe dhe si një sjellje brutale, e pa shpirt dhe e pa moral e fqinjve tanë serbë të cilët bënë masakra nga më ekstremet, të padenja për çdo popull sado i pakulturuar dhe barbar që të jetë. Barbaritë e kësaj periudhe ua kalojnë edhe atyre të periudhave më të errëta të mesjetës.

Urojmë që situata të tilla të mos përsëriten në asnjë popullsi kudo në botë.

Në kumtesën time do të paraqes materiale arkivore duke cituar burimin pa bërë asnjë koment personal për ato ngjarje të dhimbëshme për popullsinë e këtyre zonave, por edhe për të gjithë popullin shqiptar anëmbanë trojeve të veta. Lexuesi i vëmendshëm do të nxjerrë vetë konkluzionet e veta ose do t'i përdorë këto burime për studime të tjera. Materialet gjënden tërësisht nën siglën AQSH, Fondi 446 kurse dosjet dhe faqet do t'i shënojmë kur të citojmë dokumentet.

1. Letërkërkesë për ndihmë që Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës me firmën e kryetarit të saj Hoxha Kadriut.

(6)

### Nr. 707.972

Fort i nderti Zotni,

Tue e shti në veprim një vendim të Komitetit tonë më 5 mars 1919, kena nderen me Ju lajmue me një dhimë zemret të plagueme, se me të ranunit të Plavës, të Gucis e të Rugovës, mbas një qindreset kreshnike, në dorë t'anmikut tonë të papajtueshmit, prej popullit të ktyne krahinave fatzeze t'atdheut, ata qi mujtën me i pshtue me luftë mizoris serbe, u larguen tuba tuba kah Shkodra e nëpër Malcina të Gjakovës. Numri i tyne së pakti kapet deri më 15.000 frymë. Të gjithë gjinden në rrezik të faruemit nga ngushtësija e jetesës.

Zotni, nuk asht nevoja me diftue gjanë e gjatë se plagët e fituemun kreshnikisht nëpër vepra patriotike kërkojnë shërimin e tyne prej fisnikis së kombit. Nder kohna ma të rrezikshme e ma të përgjakshme t'atdheut të varruemt e të fikunt nuk mujnë me u sherue veç se me bujarinë aq të permendme të kombit arbnuer. Besojmë pra e me një mënyrë të patundshme në fisniki bujare të popullit të krahinës s'Uej dhe kërkojmë prej tij me i dalë zot njatyne të cilët kanë dijtun gjithmonë e vazhdojnë gjithnji tue dijtun me ba flije të panumërta për nder të kombit e të çështjes së tij për ta kuptua randësinë e detares qi ju perket në këtë rasë fatzeze, kena nderen me Ju paraqitë ndisinat tona ma të posaçme.

**Për Komitetin “Mprojtja Kombëtare e Kosovës”**

**Sekretari  
Kryetari  
H. Kadri**

P.S. Ndihamat t'i drejtohen Kryparis së Perlimtares së Shkodres tue lajmuepernjisherë edhe Komitetin e Kosovës.

(154)

**708.705.**

28 Fruer 1919, “në fletore”.

Kena marrë me nderime gjegjen e Ekcelencës suaj. Shiqojmë botën mizerabël me paanësinë që kishte për t'a shique një krijesë prej planetit të Marsit me teleskopin e ibretit, prandaj lutjet tona dalin prej një zemre të sinqertë e si të tilla të kemi mirësinë me iu dhanë randësinë e duhun.

Shkodra i pati hapur zemrën bujare 150.000 vetve ushtarë e popull serb që patën ikur prej rebeshit të gjermano-austriakëve barbarë në vjetin 1915 dhe i pati mbajtë e ushqye ata afër dy muaj e gjysëm. Sot në Shkodër janë afër 5000 refugjatë fatkeqë, të cilët Shkodra s'asht e zoja me i ushqye, e me i strehë për një kohë të gjatë. Këtë gja e çmoni dhe Ekselencia e juëj. E na mjerohena kur mendojmë se Shkodra do të fshajë nën një barrë kaq të randë. Me gjithë këtë shpresojmë se nga drejtësija e Shtetevet të Mdhaja tek e cila drejtësi na kena besim se refugjatët që janë strukë në Shkodër e në Malci të Jakovës do të këthehen ndër vende të veta në një kohë të shpejtë nën garancinë e Shtetevet në fjalë tue “i shpëtue nga mizerja në të cilën ndodhen”, tue iu shpërblye malli e gjaja e grabitun dhe e djegun një masë e drejtë këso dore ka me i shpëtue nga vdekja me mijëra flije të barbarizmës sllave të shpërndarë nëpër Shkodër e në Malci të Jakovës. Për kundra atyne të mjerëvet s'u ka mbetë në këtë tokë vend, veçse me u mbytë në gjol të Shkodrës.

Raporti që ju ka dhanë Shkëlqesës s'uej i nderti Komandant i Serbit për që shqiptarët kanë mësyë ma parë, mbeshtetet në mashtrimet zyrtare të serbëve për të mbulue kriminalitetin e tyne. Serbët e malazezët që dolën në vedi në formë vatrash brigadësh si pjellë e pansllavizmit dhe

e politikës ruse, u treguan shumë të zotët me mëshefë ose me shtrembnue krimet e barbarizmat që kryen që nga data e eksistencës së tyre. Serbët, te cilët kanë ardhë n'atë shkallë pjekurije sa me u ba mjeshtër, në krijim ngjarjesh e në shtremberim faktesh, i Princ Bismarkut që âsht i pari shkaktar anarkije nën të cilën po vuen sot bota, i bân me besue qarqet diplomatike europjane se shqiptarët nuk janë veçse grumbuj aventurjerash që banojnë në një vend që shtrihet prej Tirane deri në Tepelenë e se Kosova asht e banueme fund e majë prej serbësh, tue mëshefë kështu eksistencën e një milion banorëvet shqiptarë në vilajet të Kosovës.

Personalitete politike europjane që kanë në dorë mjete zyrtare munden t'u drejtojnë autoritetet të nalta e qarqevet diplomatike shkresa zyrtare në formë që dëshirojnë ato. Kurse lajmet vet private të ndonjë personi ose shkresat vetë të ndonjë komiteti s'u jepet besim për kundrejt raporteve zyrtare që jep një funksjonar qeveritar, përkundra priten me dyshim. Kjo gja asht krejt e natyrshme, e prandaj Komanda e Kotorit paraqet shqiptarët si agresorë mbi informatat zyrtare qe ka parë prej Serbëvevet e Malazevzet. Por ata i bâjnë këto shpifje me mëshefë realitetin dhe me shgarkuevedin nga përgjegjësjia e krimevet. Se pretendimet e serbëvevet janë krejt shpifje provohen me faktet që po shënojmë këtu poshtë:

a) Siç kemi shpjegue në raportin me datë ....dhe n'aneksin e saj statistikën, në krahinë të Podgorit janë plaçkitë ..... shpija, djegë....., shpja dhe vra..... vetë. Mbas dy ditëvevet që u kryen këto krime, si shkak treguen serbët thyemjen e postës prej një brigandi që ndodhej i arratisun në mal ç'prej disa vjetësh.

b) Në Tregovishtë u vran mâ se njëqind shqiptarë pa kurrfarë shkakut dhe iu plaçkit pasunija.

c) N'Akovëmâ se tetqind vetë u vranë barbarisht, iu plaçkitën teshat e shpijavet dhe bagtija. Nga familjet e para të vendit u marrën 46 vajza, prej të cilavet gjashtë u dhunuen në nderë. Tjerat për të psue po këtë fat u çuen mbrënda nder tokat e Malit Zi. Gjithë këta fatzezë, ndejë në qetsi ndër shpija të tyre, a gërganë serbët qe u vranë? Ç'fuqi kishin grat e pafaj e vajzat virgjine që u çnderuan n'atë mënyrë?

ç) Me raportet e ndryshme qe japin ç'prej tre muajvet dhe me fakte e kenaprovue se Serbët e Malazezët do të mësyjnë Plavën e Gucinë dhe do t'i masakrojnë banorët e tyne.

Ngjarjet e dëshmuen këtë qëllim tradhtar te Serbëvet. Vonesa deri më sot më çue në vend këto plane kriminale të parashestueme, rrjedhtë nga shkakut se fuqija e përqndrueme malazeze s'ishte e mjaftë e pritej të vijoshin fuqina ndihmtare serbe. E kur mbërijtënfuqinat e rregullta serbe me topa e mitraloza, atëhere u hap sqena e krimevete. Fuqinat ushtarake sllave, që deri atëherë përgjoishin, filluen operacionet e paramendueme. Ç'prej tre muajsh filluen masakrat e plaçkitjet n'Akoshë, në Tergovisht, në Peshterë, në Podgor e ngjeti dhe barbarizmat në Podgoricë. Plava e Gucije nën ankthin e këtyre tmerrevet, nuk mund të bajshin tjetër veçse me mprojtë jetën e nderen e vet ndaj bishët e egra që vijshnin prej visevet të ndryshme të Malit – Zi dhe ndaj fuqit e rregullta ushtarake të Serbvet. Pra me tregue agresor një popull që mprohet, kjo s'asht tjetër veçse një shpifjes që s'e pranon arrsyjeja. Kur serbët rrënojnë e djejin gjithçka me bomba, topa e mitraljoza për mos me lanë gjallë një prej racës shqiptare, si pretendojnë se janë agresorë pleqtë, gratë e fëmitë që bahen kortarë kortarë nën breshninë e plumbave tmitraljovet? Sikur serbët pa pasë turp t'a bajnë këtë pretendim, a gjëndet ndonjë ndërgjegje e shëndoshtë që t'a pranojnë këtë gjâ?

d) serbët, në kundreshtim me parimet ligjore sot në fuqi, ia vën në formë të një detyrimi popullit mbajtjen e ushqimin e gjëndarmërisë e të fuqisë ushtarake që kanë instalue në krahinë të Rugovës, dhe me këtë rasë vijoje me shtypë popullin me gjithfarë mënyrësh.

Veprat barbare qe po shënojmë poshtë, shpjegojnë qëllimin që ndjekin serbët: Në katundin Koshotan të krahinës së Rugovës kanë grabitë 200 krenë dhën të Jashar Murtit, 280 të Hys Mzasë, 100 të Sadri Hazirit e 200 të Met Zyberit, Abdyl Hazirit, P.S. Ne fusnote shenohen emrat si duhet: Jashar Myrti, Hys Musa, Sadri Haziri, Metë Zymeri, Avdyl Haziri. i kanë vrà 3 barijtë. Zymer Smajlin e kanë vrà dhe i kanë plaçkitë shtëpinë, kanë vra dhe Salih Alinë bashkë me shokun e tij Temo Ramon (duhet: Ramn) kur po këthejshin nga Peja në katund. Bajram Rrustemit, i kanë grabitë 280 krenë dele prej katundit Drellas (duhet: Drelaj) dhe e kanë vrà. Kështu kanë vra dhe Rexh Haxhinë kur ky deshti të mbyllë derën në kohën që Serbët kishin fillue me ia plaçkitë shpinë.

Në katund të Koshishtës kanë vrà Xhixh Sakolin (?) dhe i kanë marrë me dhunë 60 dele, 3 lopë e një kal dhe gjithë drithin që kishte. Në katundin Bukel i kanë grabitë 140 dele MurselSalihit, 60 Abedin Baxhujit dhe 70 Halil Zeqës, tue i vrà për fund dhe këta të tre. Në katundin Bisirnicë kanë vrà Mehmed Ismailin, Ibish Bajramin dhe tre barinj bashkë me njëqind krenë dele. Për me ushqye popullin e Malit-Zi u kanë marrë me dhunë drithin katundevet të vorfna që u përmendën sipër dhe katundevet të tjera në Jakovë, tue lanë pa bukë vetë popullsinë e atyne katundevet. Në katundin Pepiç iu dhunohet nderi...grave. Dëshprimi i familjeve të tyne arrijnë kulmin.

Një katundar, të cilit i asht grabitë drithi blen një barrë drithë dhe e nisë për në katund me djalin e vet. Por sa djaloçi vjen në postë të Beluhës gjandarmët malazez i marrin me dhunë drithin e kalin dhe vrasin djaloçin me urdhën të kapitenit. I ati e familja i drejtohen kapitenit e kërkojnë djalin, kalin e drithin? Kapiteni gjegjet se djali asht vra. Atëhere aty nisë nizaja dhe populli alarmohet.

Komandanti serb në Plavë u jep autorizim dyzet vetve me shkue në Pejë me blë drithë. Kur këthejnë i ndalon komandanti i gjandarmërisë malazeze në postin Beluhë, grabisin kuajt me gjithë drithë, dhe vrasin dy prej tyne, me gjithëse ata deklarojnë se këtë drithë e barshin për ushtarët serbë. Këto sjellje t'egra merzisin e dëshprojnë bajraktarët e krahinës së Rugovës. Këta kërkojnë me gjetë mënyrën si e si t'u vihet një frë këtyre veprave dhe lypin një pjekje me Komandën e Pejës, për me ia parashtrure këtij ankimet e popullit. Kapiteni komandant i Pejës vjen në Peklenë te Guri i Biruem. Por këtu, mu të Qafa e Hajlës, hap zjerm kundra bajraktarëve një fuqi që kishte ardhë prej Rozhaje. Bajraktarë e popull që pritshin vendosjen e një qetsije e siguriye, kur ndodhen përpara një zjermi që hapin ushtarët serbo-malazezë, ata natyrisht çohen e mprojnë jetën e tyne.

E qe, kështu fillon ngjarja e Rrugovës, shkaktarët e vetëm të se cilës janë ata që hapën mâ të parët zjerm. Me ia ngjtitë këtë faj shqiptarëve, asht tamam puna e atij kriminelit, i cili për me qitë vedin te pafaj iu ngarkon këtë të tjerëvet. Asht kjo një akuzë për t'u pranue? Shkaktarët e autorët e ngjarjes fatale të Plavës e të Gucisë, provohen si vijon poshtë:

a) Shtat ditë para ngjarjes komandanti serb me banim në Plavë fton Hasan agë Ferrin, ShaqirMuslinë, Jusuf Ramën e Mehmed aga Ferrin, pari e vendit dhe iu komunikon se gjithkahë në Mal të Zi asht dhanë urdhën me shëmbë Plavë, Guci e rrethe me spata, bomba, top e me mitraljoza.

b) Për ne asht një fakt i provuem sugjerimi që u ka ba komandantavet të serbit e të Malit të Zi Princi Aleksandër, që kthente nga Parizi në Nish, për me shtypë patjetër popullsinë e Plavës, e të Gucisë dhe me i shpartallue këto dy krahina, mbasi kauza kombëtare serbe do të pagujë dame nga gjëndja që paraqesin këto.

c) Katundi Bebiç asht rrënue përpara ngjarjes dhe Sllavëve të Brezoviçit u asht dhanë leja me vra shqiptarët po mâ përpara, dhe sllavët kanë vra disa shqiptarë.

d) Rruga në medis të Plavës e të Gucisë asht prë, një javë ma parë, dhe komandanti serb ka instalue në kullë të StanishaTurkoviçit në katund të Vojnaselës dhetë ushtarë me një mitraljoz, të cilët kanë vrà me mitraloz Ram Bajramin prej Rugove, Hasan Mashin prej Vuthaj dhe të shoqen e Sul Demës prej Shkreli bashkë me katër krenë lopë, kur po kalojshin andej pari.

dh) Fuqitë serbo-malazeze po shtohen dita ditës dhe kanë fillue me shtypë Plavën e Gucinë. Malazezët kanë mësyenokshiqin e prej aty Çakovën, kurse fuqitë serbe prej Peje kanë dalë në Qafë e prej këtu në Metehe, ku kanë vu topa dhe kanë bombardue e djegë Metehen e Komarashin. Mandej kanë bartë topat në Kumarash dhe prej këtu kanë nisë me rrënue Plavën e Gucinë. Në këtë çast me urdhën të komandantit serb që gjëndej në Plavë ushtarët kanë fillue me hapë zjerm kundra popullit e kundra shpijavet.

Populli i Plavës dhe i Gucisë që pat kuptua ç'prej tre muej e gjysë qëllimet dhe sjelljet e malazezëve e të serbëve, u çuen e mbrojtën vendet e tyne, jetën e gravet e të kalamajvet të tyne prej pritavet që kishin pregatitë prej dhen.

Një hetim mjafton me qitë në shesh se cilët janë shkaktarë të kësaj gjendje. Prandaj nga ndënjat e larta e fisnike të Shkëlqesës s'uej lusim me marrë masa të ngutshme me këthye refugjatët e mjerë ndër vende të veta nën garancinë e shtetevet të mëdha për t'i shpëtue nga

vdekja, dhe me i vû ato vise, deri në kohën e paqes, nën një administratë ndërkombëtare tue i detyrue shkaktarët me iu shpërblye edhe damet.

-----

**Vertetohet njejtësija me origjinalin  
drejtori' drejtoris së arkivave të  
m. p. të brendeshme te r. p. sh.  
gjeneral-major  
(Veli Dedi)**

**Komiteti  
“Mprojtja Kombëtare e Kosovës”  
(qendra e përjashteshme)  
Nr. 334**

**Shkodrë, më 31.8.1919**

**Të nderueshmes**

**Kryeparis së Klubit të Kolonisë Shqiptare Stamboll**

I nderueshmi Kryepar,

Tue perfitumun prej një rase të bukur po vijëm me Ju lutë qi të keni mirësiën me u perpiekë mbi këtë pikë” Komiteti “Mprojtja Kombëtare e Kosovës” ka, sidomos, 10 mujë qi vepron pà prà per me i shti në veprim këtë dy pika:

a) Me sigurue një Shqipni të lirë nder kufi të saj ethnike.

b) Me e lajmue botën zyrtare e jashtëzyrtare mbi krejt punët qi rriedhin në Shqipni e kundra shqiptarëve prej dorës së anmiqve. Komiteti ka per të veprumun në këtë rrugë deri më atë ditë qi kan per t’iu vue kufit Shqipnis e mrapa ka me vendumun e ka nevojë per të apo jo.

Në ditë sodit per me i bâ ball rreziqeve qi munden me rriedhë prej intrigave të huja, Komiteti asht shtrengumun me veprumun rreptësisht e pà prà. Per me e mri qellimin e vet Arka e Komitetit asht shtrengumun me prishë shuma të mbëdhaja. Ju lutemi prà, tue marrë parasysh nevojen e madhe qi ka Shqipnia prej krejt biët e vet besnikë, të bâni një mbledhië

të pergjitheshme e t'i merrni krejt masat e nevojshme per me i ndimue me të holla arkës së Komitetit tonë sa ma para e si e sa të mundeni.

Shqiptarit kurr nuk ka me i ra një rasë ma të bukur për me e sprovue besnikinë e vet për atdhë e për troje të të PARËVE.

Ju përshnetojëm vllazënisht e besnikisht.  
Për Komitetin “Mprojtja Kombëtare e Kosovës”

**Sekretari  
Kryetari  
Bedri Peja  
H. Kadri**

**Shkodrë, më 6.XI.1919**

**Komiteti  
“Mprojtja Kombëtare e Kosovës”  
(qendra e përjashteshme)  
Nr. 396**

**Zotniës së Tij  
Patrë DEDES  
Famullitari i Kishës së Shalës, Abat**

I dashtuni Zotni e Mik,  
Të faluna e pershnetime nga zemra.  
U lutemi fort me i marrë këtë masa:

1. – Me organizue posten ndermjet Komitetit e Hysni beg Currit ndepermjet të gjendarmëve ma të besnik të Shales, të Shoshit e Nikaj e Mertuer.

Kio pikë asht teper e nevojshme per me mujtë Komiteti me marrë masa të shpeita kahë Shqipnia e Mesme e kahë Toskënia në kioftë se serbët nuk dojnë me ndigjue me i lshuekufiët e Londonit veç se me luftë.

Kio pikë na duhet pa hall dhë per me mujtë me lajmue me vakt Parisin e diplomatiën e Amerikes e të Europës.

2. – Në kioftë se ka krisë pushka këtej Qafës së Morinës e serbët bajën inad, me njiheri, duhet qi t'a bashkoni fuqiën e Shales e të Shoshit

e ta nxeni sa ma parë Majen e Pejës. Mrapa lufta bâni zgjati të përgatiteni moralisht e landërisht për me msye Plavë e Gusinë.

3. – Duhet pa hall qi serbi të largohet prej Thethit, prej Vukli e prej Seltzet.

4. – Në Kruatië, në Bosnië e nder vende tiera të Jugosllaviës ka plasë kryengritia e serbi kurr nuk ka kënë ma ngusht se sot. Shpeitoni bashkimin e forcimin e besës e mirrni masa për me i ndimue, në pastë nevojë, dhë Hysni begut. Shkurt: Ka mrrinë për ne dita me i librue së pakti kufiet e Londonit.

5. – Diplomazia serbe asht diskreditue aq keqas sa jena sigurt qi, runa Zot, dhë me bierrë në luftë kena për të fitue politikisht.

6. – Në kioftë se Kryengritia vazhdon dhë përhapet kah rrafshi i Pejës e i Gjakovës për me shkue kah Fusha e Kosovës, Hysni beg Curri i ka të gjitha instruksionet mbi këtë pikë.

7. – Komiteti ka për t'i marrë të gjitha masat për me i dalë punës në kry me fitim të Shqipniës.

8. – Lajmonani me të shpeit shka ka rriedhë deri sot e shka mundet me rriedhë sot e mrapa.

9. – Qerimi mundet me na vytë fort në këtë punë.

U pershnetojëm dhë një herë.

Per Komitetin “Mprojtja Kombëtare e Kosoves”

Sekretari

Kryepari

**SHËNIM** me randësië – Mbas një lajmit të mramë e sigurt qi ka marrë Komiteti Kryepari i Delegationit Amerikan në Konferencë të Paqes ka dftue se Aj e Qeveria Amerikane ka për t'i dalë zot çashties së Shqipniës me të gjitha miete të Amerikes.

Komiteti.

### **Dok. 708.781, faqe 1-2**

Të naltës Kryesi së Shoqnisë “Mprojtja Kombëtare e Kosovës” në Shkodër

Mendimet e qëllimet e serbëve e të malazezëve për Plavë e Guci dihen. Me gjith premtimet e dhanuna prej Mbretnijvet të Mbëdhaja ashtu dhe sigurimet, serbët e malazezët orvaten të na mërzhisin tue na rrethue ka

zânat tona. Bajnë të këqija dhe kanë qëllime kriminale me na therë kalamajt. Kanë mbyllë rrugën e Pejës, kanë ndalue komunikacionin dhe s'lanë njeri me kalue. Dhe për të realizue këtë gjâ kanë qitë patrulla ushtarake në vendin që quhet Bluhe në Plavë. Aty po i grabisin popullit kashtën e gjân'egjall. Ç'u vjen përdore po bâjnë kundra popullit. Komandanti i Plavës kanë çue 15 vendas me kafshët e tyne prej Gucije në Pejë për me bartë plaçka ushtarake. Këta janë shoqnie prej një patrulle ushtarake dhe 4 vetë tue mos pasë në Pejë çka me u ngarkue, sepse kanë mjaftue kafshët e tjera, për mos me u ktye bosh, kanë ble dhe ngarkuedrith për vedi. Kur kanë ardhë në Blohe, janë sulmue prej malazezve. Kanë burgosë njerzit, iu kanë bâ lloj lloj poshtrimesh dhe ma në fund, iu kanë grabitë katër barrët e drithit.

Këta shqiptarë të shkretë kanë kthye të dëshpëruem ndër shpija të veta. Peja asht gryka e shpirtit tonë, pra a âsht e mundshme për ne me qendruë të çkputun prej saj?

Shpresojmë se Mbretinjet e Mdhaja s'kan m'e pa t'udhes të jesim na kështu rob e të rrethuem. Qëllimet e serbëvet e të malazezvet janë për fushë: me na rrethue, me na robnue e mandej me na çfarue.

Ju lutena, porsa të ju mbërrijë në dorë kjo letër, përpiquni me na celë rrugën, me ndalue qëllimet kriminale të serbo-malazezvet dhe mësymjet e tyne kundra tokavet tona. Vrapojmë me ju bâ këtë lutje me nxehtësinë mâ të madhe që të mos vononi as një minutë në demarshet e juaja.

Ju theksojmë edhe këtë se të zotët e meqarevet por sa kanë shkue në Pejë i kanë rrahë serbët dhe malazezët, i kanë burgosë dhe torturue në gjithfarë mënyrash.

Lutena prap me na ra mrapa pa vonesë dhe me na sigurue që kazatë tona të merren nën një vendim ndërkombëtar.

Fruer 1919.

N'emën të tanëvet

Nga paria e Plavës

Hasan aga Feri

Shaban Beu

Shelko Ajdin Aga

Nga pari e Gucisë

Shaqir Halili

Ismail Hysejni

Sejdi Zuka

408.781

21  
191

Pe malltes kryeu së shoqërisë "Mbrojtja  
Kombëtare e Kosovës" në Shkup.

Mendimet e qellimet e Serbëve e të Malazg-  
vet për Slavë e Guci dihen. Me gjithë përmirësimet e  
diamonit prej mbretërisvet të mbështetja ashtu dhe  
sigurimet, Serbët e Malazgëzët orëton të na mer-  
zisin tue na rrethojnë krahinat t'ona. Baza të  
llogja dhe kanë qelime kriminale me na hëri  
kalamajt. kanë mbyllë rrugën e Pejës, kanë nda-  
lu komunistkazonin dhe s'kanë ymer me kaluar.

Ibe për të realizue këtë qja kanë qitë pabrualla  
ushtarake në vendin që qehet Bluche në Slavë.

Aty po i grabim popullit krahinën e gjatë e gjollt  
e' a ymer për durr po bojnë kundra popullit.

Komandanti i Slavës kanë cun 15 vendos me  
kapitët e tyre prej gucës në Pejë për me barti  
plaçka ushtarake. Këta janë shoqëri prej një  
pabrualla ushtarake dhe 4 vetë të m'pasi në Pejë dja  
one t' m'arhja se kanë m'qarta kapitët t'era për

mas me këthye e'at kanë kë e m'arhja dritit  
për vedi kur kanë ardhë në Bluche janë zulum  
prej Malazgëzvet kanë burgos m'ezet, i kanë  
të llog llog p'stitimok dhe ma në fund in  
kanë grabitë 4 karret e dritit. Këta shqiptari

të shkratë kanë këthye të d'ed'pueson ndëe d'ed'p  
të veta. Peja asht gryka e shpirtit t'ona, pra  
a asht e mundim për me në me g'e polue të  
g'lepatun prej e'oj. Shpërrojme se mbretërit e

ndihaja s'kanë m'e pa t'uollat të jesisu na  
hështu rob e të rrethojmë. Qellimet e Serbëve

22 Sp. 2

e të Malazezvet janë për fushë: me na vretur  
me na robnuar e mandej me na shfarur. Ju lutem,  
për sa të ju mbërrijë në dorë kjo letër përfaqëse  
me na çelë rrugën, me ndaluar qellimet kri-  
minale të Serbo-Malazezvet dhe nësyrerit e  
tyre kundërna tokave të ~~tyra~~ t'ona. Thirrja  
me ju t'ua këtë lufte me ngjitetim më të madhe  
që të mos vononi as një minutë ndër demar-  
shet e juaja.

Ju thirrjmë dhe këtë se të zotët e mesazhet  
për sa kanë shprehur në Dje i krahë vrabi Ser-  
bet dhe Malazezet, i kanë burgosur e torturuar me  
gjithfarë mënyrësh.

Lutemë prop me na mirajpa po vononi  
dhe me sigurim që krahët t'ona të marrin nën  
një sundim ndërkombëtar.

-- (?) pruer 1919.

U'ëmën të tanëve  
nga pari e Slavës  
Hasan aga Jeri  
Shaban Ben  
Shelko Ajdin aga

nga pari e Jucisë  
Shajir Halili  
Tomail Hysëni  
Pjedi Zullu

\*

250

**Dr. Sc. Mark Palnikaj, Polytechnic University of Tirana**

**RUGOVA 'S POPULATION MIGRATION IN 1919 FROM THE  
VIOLENCE AND GENOCIDE OF MONTENEGRO AND SERBIA,  
ACCORDING TO ARCHIVAL RECORDS OF THE CENTRAL  
STATE ARCHIVE IN TIRANA**

In 1919, Rugova's population was displaced from the violence and genocide of Montenegro and Serbia, according to archival records of the Central State Archives in Tirana. The paper is not built on the basis of memories, but based on archival documents, which are stored in the Central Archive of the Albanian State for the events of 1919 in the surroundings of Peja and especially in Rugova. The attentive reader will draw its own conclusions or use these sources for other studies. The materials are found entirely under the AQSH logo, Fund 446, while the files and pages will be marked when we cite the documents. Out of around 90 pages of documents we chose to present only these, considering that a number of them were published on this anniversary. The list of massacred persons, burned alive and missing in other forms is located in an archive in French with 432 listed persons.

**Burimet arkivore**

- Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar:Fondi i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, viti 1919 ,skeda II. 2/13. Dosjet 52, 50/2, 50, 46, 28/4, 28/3, 28, 22, 14, 13, 8 dhefondi nr. 152 dosja 8.